



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 144/3 Prot

Tiranë, më 25.05.2021

V E N D I M

Nr.56, datë 25.05.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, mbi vlerësimin e ligjshmërisë së ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit tatimor *** dhe marrjen ndaj tij të vendimit për largim nga shërbimi civil.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e informacionit të përcjellë nga nëpunësi ***** , për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore dhe marrjes së vendimit për largim nga shërbimi civil, nga ana e Komisionit Disiplinor

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar me nr. 144, datë 15.02.2021, nëpunësi tatimor ***** ka ngritur pretendimin se ndaj tij ka filluar dhe është zhvilluar një ecuri e padrejtë disiplinore, në shkelje të ligjit material dhe atij procedural, si dhe është marrë masa disiplinore largim nga shërbimi civil, në mënyrë të padrejtë.

Nga këqyrja e dokumentacioni të mbledhur gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, konstatohet që nëpunësi tatimor ***** , ka qenë nëpunës civil i konfirmuar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit”, në Drejtorinë Rajonale Tatimore (DRT)

Korçë deri në momentin kur, me aktin e njësisë përgjegjëse (DAP) nr.2830/529 prot., datë 23.07.2020 “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, ka kaluar në pozicionin “*Përgjegjës në sektorin e shërbimit të tatimpagueve*”, në DRT Korçë, si pasojë e ristrukturimit të institucionit.

Shkaku i fillimit të këtij procesi verifikimi, lidhet me faktin se Drejtorja e Investigimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ka kërkuar fillimin e ecurisë disiplinore, për nëpunësin *****, me pretendimin se nëpunësi në fjalë, në periudhën kohore 09.08.2020 deri në 25.08.2020, në kundërshtim me detyrat e tij funksionale ka procesuar çështje në sistemin informatik tatimor C@ts, të cilat kanë bërë të mundur kalimin e tepricës kreditore nga një tatimpagues në një tatimpagues tjetër, duke favorizuar disa tatimpagues me detyrime tatimore, veprime këto që vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në RSH*” dhe me nenin 7 “*Përgjegjësitë dhe detyrat e Përgjegjësit të Shërbimit të Tatimpaguesve*” të urdhrit nr. 192, datë 12.08.2020 “*Për miratimin e rregullores se funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore*”.

Konkluzionet e mësipërme, janë arritur pas marrjes së informacionit zyrtar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), në lidhje me punonjësit që kanë aksesuar/procesuar një sërë çështjesh (*që janë renditur në mënyrë të shprehur, në këtë informacion*) dhe logini (IP) në këto USER’S. Konkluzioni i AKSHI-t është se në gjithë këto çështje “*Aprovimi i dytë*” janë kryer nga punonjësi *****, dhe janë procesuar jashtë orarit zyrtar, nga IP publike.

Këto veprime të nëpunësit *****, janë analizuar nga eprori direkt, i cili ka arritur në konkluzionin se ato përbëjnë thyerje të rëndë të disiplinës në punë duke i klasifikuar si shkelje “*shumë e rënda*”, parashikuar kjo nga pika 2, e nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar e, për këtë arsye, ka kërkuar që çështja të kalojë për kompetencë dhe të shqyrtohet nga Komisioni Disiplinor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Në këto kushte, bazuar në pikën 2, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, drejtuesi i institucionit, ka nxjerrë urdhrin nr. 18472 prot., datë 22.09.2020 “*Për ngritjen e Komisionit Disiplinor*”, akt i cili sipas parashikimeve të nenit 57, (pika 2) dhe nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, i është njoftuar nëpunësit të proceduar, me shkresën nr. 18118/3, datë 22.09.2020 “*Fillim i ecurisë disiplinore*”, duke i bërë të ditur njëherësh, të drejtën e tij për të paraqitur sqarimet rreth shkeljes së pretenduar, si dhe datën e shqyrtimit të shkeljes së pretenduar.

Në vijim, siç rezulton nga përmbajtja e procesverbaleve të Komisionit Disiplinor të datës 30.12.2020 dhe 27.01.2021, është kryer procesi i dëgjimit të palëve, ku nëpunësi i proceduar është njohur me pretendimet dhe provat për ndërhyrje të parregullt në sistemin C@TS.

Ndërkaq, nisur nga fakti se nëpunësi i proceduar kishte akses në sistem dhe ekzistonte mundësia që ai të ndërhynte në ndryshimin e të dhënave, Komisioni i Disiplinës ka marrë vendimin e ndërmjetëm me nr. 613, datë 30.09.2020, për pezullimin e tij nga detyra deri në përfundim të hetimit administrativ. Më pas, për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe kryerjes së verifikimeve plotësuese, sipas pretendimeve të palëve, Komisioni Disiplinor me vendimin nr. 760, datë 31.12.2020, ka vendosur zgjatjen e afatit për përfundimin e çështjes, duke argumentuar në këtë mënyrë edhe shkakun e tejkalimit të afatit në shqyrtimin e çështjeve administrative.

Në përfundim të hetimit administrativ, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të gjithë provave të mbledhura për shkeljen disiplinore të pretenduar, Komisioni i Disiplinës, bazuar në pikën 4, të nenit 60, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se, *“për shkeljet shumë të rënda të parashikuara në pikën 2, të nenit 57, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “ç” të nenit 58, të këtij ligji”*, me vendimin nr.22, datë 29.02.2021, ka vendosur të marrë masën disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*, për nëpunësin *****.

Nga gjithë sa u parashtrua më sipër, nisur nga përmbajtja e dokumentacionit në të cilat materializohet procedura dhe shkelja disiplinore, arrihet në konkluzionin se, si nga pikëpamja procedurale ashtu dhe ajo materiale, janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit, duke filluar nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, vënies në dijeni për këtë fakt, të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, dëgjimin e thënieve të tij dhe administrimin e provave materiale të nevojshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në nenin 90 pika 1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së ecurisë disiplinore dhe vendimit për *“Largim nga shërbimi civil”* të nëpunësit ***** , filluar në bazë të kërkesës së tij me nr. 144, datë 15.02.2021, dhe meqënëse veprimet dhe vendimi i Komisionit Disiplinor, gjenden në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, arkivimin e çështjes.

2. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha